

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 25 NËNTOR 2021

Të nderuar kolegë,

Të nderuar bashkëqytetarë,

Në vitin 2016 ky parlament ratifikoi një marrëveshje shumë të rëndësishme midis qeverisë shqiptare dhe qeverisë italiane për realizimin e një rrjeti rrugor funksional, që do të favorizonte shkëmbimin e mallrave, lëvizjen e qytetarëve me vendet kufitare dhe përmirësimin e rrjetit rrugor ndërmjet pjesës veriore të vendit, si pjesa më e varfër e Shqipërisë, zonave të tjera të vendit dhe me Malin e Zi. Mirëpo, edhe pse kanë kaluar 5 vjet, kjo marrëveshje është futur në kalendrat greke, pa shpresë që të kthehet në një marrëveshje që t'u shërbejë qytetarëve të Veriut të varfër të Shqipërisë. Marrëveshja për financimin Milot-Shkodër ka mbetur vetëm në letër, e mbuluar me pluhur në sirtarët e qeverisë. Një nga akset më të rëndësishme kombëtare që lidh dy qarqet kryesore të vendit, Shkodrën dhe Lezhën, si dhe aksin e vetëm që lidh Malin e Zi me Shqipërisë, ka mbetur rrugëve pa asnjë investim, ndonëse në këtë marrëveshje ishte parashikuar ndërhyrja kryesore infrastrukturore. Kjo qeveri nga mëngjesi deri në darkë bërtet për turizmin, por e ka lënë këtë aks rrugor pa asnjë investim, pavarësisht se është aksi kryesor turistik i Shëngjinit, Velipojës apo i të gjithë zonës veriore të Shqipërisë dhe të turizmit malor. Si ka mundësi që për 5 vjet ky projekt nuk u realizua? A mos është e qëllimshme kjo harresë? Mos ndoshta ju nuk doni ta bëni këtë investim të rëndësishëm për jetën e qytetarëve të këtyre zonave, duke e lënë turizmin e Veriut të izoluar dhe pa perspektivë? Unë nuk dua ta besoj këtë, por faktet janë kokëforta.

Ndërsa gjendja e këtyre rrugëve është skandaloze, sot ju kërkoni të bëni transferimin e këtyre fondeve, të përfituar nga kjo marrëveshje, për të bërë bajpasin e Elbasanit, të Beratit apo rrugën Elbasan-Quks. Kjo do të jetë situata alarmante dhe skandaloze për qytetarët e asaj zone, që kishin një pritshmëri të lartë për atë zonë. Heqja e këtij fondi, të përfituar nga një marrëveshje e 5 vjetëve më parë, është diskriminuese për Veriun e Shqipërisë, për qytetarët e Kosovës dhe për mjaft qytetarë të tjerë të huaj, që për 1001 arsye udhëtojnë në këtë aks mjaft të rëndësishëm. Si ka mundësi që në 4 vjet mbaroi autostrada e Kombit nga Morina në Rrëshen apo në Thumanë, ndërsa sot e 9 vjet nuk është bërë asnjë kilometër rrugë në këtë aks mjaft të rëndësishëm? Një qytetar kosovar vjen në autostradë të ndërtuar vetëm 10 vjetët e fundit në Kosovë nga Mitrovica, nga Prishtina, nga Peja, nga Hani Elezit, nga Gjakova dhe Prizreni deri në Milot dhe Thumanë, por më pas ngelet në trafikun e rënduar për të shkuar në Shëngjin të Lezhës apo për të shkuar në Velipojë të Shkodrës, në plazhin e Durrësit e në atë të Jugut, apo për të ardhur në kryeqytetin e Shqipërisë. A e dini ju zotërinj rilindës që mbi 55% të turistëve të Shqipërisë vijnë nga Kosova dhe veç pagesës 10 euro, që paguajnë në traun e vendosur po nga ju, ata duhet të marrin në konsideratë edhe tmerrin e orëve pa fund në trafikun e muajve të nxehtë të verës. Kjo ka vetëm një motiv: qeveria e Edi Ramës nuk i do veriorët apo nuk i do edhe shqiptarët e Kosovës. Të paktën ju, kolegë deputetë, apo ju, ministra, që keni ardhur këtu me votën e veriorëve apo të atyre

zonave, duhet të reagoni. Ju nuk guxoni ta bëni një gjë të tillë. Ndaj jam i sigurt që edhe qytetarët tashmë e dinë këtë. Në buxhetin e mjerimit, që u keni ofruar shqiptarëve për vitin e ardhshëm nuk ka asnjë qindarkë të planifikuar për rrugën më të rëndësishme, që e bën Rrugën e Kombit 100% funksionale, për vazhdimin e autostradës, pra për aksin Rrëshen-Milot-Lezhë-Shkodër, për aksin Thumanë-Tiranë, për aksin Thumanë-Vorë apo për ta lidhur atë me kryeqytetin e Shqipërisë. E pra, të dashur kolegë, gjatë gjithë verës, por edhe sot që flasim, këto akse rrugore janë të pakalueshme dhe torturose për banorët e këtyre zonave, si dhe për mjaft turistë vendas e të huaj. Tani që paratë e projektit i keni çuar në zonat ku keni interesa elektorale, çfarë do të bëhet me këtë aks të rëndësishëm dhe jetik për lidhjen e Veriut të Shqipërisë me pjesën tjetër të vendit, sidomos për destinacion turistik? Pse Rruga e Arbrit nuk do të mbyllet brenda vitit 2021, siç premtuat në programin 4-vjeçar, në seancën e parë të këtij parlamenti? Pse aksi Bulqizë-tuneli Qafë Thanë deri tek Ura e Vashës, që ka qenë gati për t'u asfaltuar që në vitin 2013, nuk është asfaltuar në 8 vjet? Madje as në vitin e parë të këtij mandati nuk do të asfaltohet. Apo do të bëni shtesë kontrate miliona euro si me Rrugën e Elbasanit, me rrugën Lin-Pogradec, me bajpasin e Fierit, me bajpasin e Vlorës apo me rrugën e Kardhiqit dhe rrugën Qukës- Qafë Plloçë?

Edhe sa vite ju duhen që qyteti i Peshkopisë ose qindra qytetarë të qarkut të Dibrës të lidhen me një rrugë bashkëkohore, me një afat të parashikuar edhe nga ju para 8 vjetësh, kur keni ardhur në pushtet? Pse qeveria nuk ka një plan zhvillimi infrastrukturor të miratuar dhe të renditur sipas rëndësisë ekonomike dhe fizibilitetit, por edhe zhvillimit proporcional gjeografik të Shqipërisë? Edi Rama nuk ka firmosur ende një VKM të vetme për strategjinë e zhvillimit rrugor shqiptar. Sot që flasim nuk ka një projekt infrastrukturor rrugor për lidhjen e 4 qarqeve të Veriut, qyteteve apo njësive administrative dhe çdo fshati të këtyre zonave. Nuk ka, sepse ju nuk e doni fare Veriun në hartën e investimeve. Ky është diskriminim politik, pasi këto janë qarqet ku ju nuk keni fituar dhe nuk keni marrë votëbesimin. Ndaj sot, nga kjo sallë e përfaqësimit të popullit, ju bëj apel të mos e diskriminoni më tej këtë zonë, të mos e ndëshkoni më shumë këtë zonë të varfër, që vuan pasojat e keqqeverisjes apo diskriminimit tuaj politik!